

Vlerësimi i Ekonomisë Shqiptare

Tremujori i Tretë i Vitit 2001

I. Ekonomia botërore¹

Ekonomia botërore edhe gjatë këtij tremujori vazhdoi të demonstronte shenja ngadalësimi. Shenjat e para të këtij ngadalësimi janë vërejtur në muajt e parë të vitit. Ngjarjet e 11 shtatorit, rritën pasigurinë e konsumatorëve dhe të investitorëve jo vetëm në SHBA, por edhe në vende të tjera të botës. Rezultati ishte thellim i ngadalësimit apo edhe i rënies ekonomike për zona të caktuara.

Ekonomia amerikane, gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, u tkurr me një ritëm vjetor prej 0.4 për qind. Papunësia në muajin shtator ishte 5.4 për qind dhe inflacioni 2.6 për qind. Gjatë tremujorit u vu re një rënie e madhe në këta përbërës të PBB-së: investimi fiks jorezidencial (-12 për qind), eksportet dhe importet në terma realë të mallrave dhe shërbimeve (-17 dhe -15 për qind). Gjendja einventarëve ka rënë me rreth 60 për qind në krahasim me tremujorin e mëparshëm ndërkohë që shumë firma vazhdojnë të shesin me çmime të ulura "duke vjedhur" kështu të ardhura nga muajt të vazhdim. Në muajin nëntor, u deklarua² se SHBA janë në recesion dhe se kjo rënie ka filluar që në muajin mars të këtij viti.

PBB-ja e **Japonisë** u tkurr me 0.5 për qind gjatë tremujorit të tretë ose me 2.2 për qind në bazë vjetore. Po në këtë periudhë, porositë për makineri ranë me 20 për qind. Vendi kërcënohet nga deflacioni, i cili ka arritur nivelin rreth 1 për qind në vit. Borxhi i jashtëm i vendit qëndron në nivele alarmante (130 për qind e PBB-së) ndërkohë që sistemi bankar nuk ka gjetur një rrugëdalje nga problemi i kredive të këqija. Nën dritën e zhvillimeve të fundit ekonomia e vendit pritet të tkurret me 0.75 për qind në vitin 2001 dhe 1 për qind në vitin 2002.

¹ Të dhënat për ekonominë amerikane dhe japoneze janë marrë nga Bureau of Economic Analysis dhe "The Economist", 12 Dhjetor, 2001.

² Deklarata është bërë nga Komiteti i Përcaktimit të Cikleve të Biznesit i Byrosë Kombëtare të Kërkimeve Ekonomike.

Ekonomia europiane³

Rritja ekonomike për zonën e euros gjatë tremujorit të tretë ishte 0.1 për qind. Rritja më e madhe u vu re në konsumin privat (0.6 për qind) ndërsa rënia më e madhe ishte ajo e eksporteve (-1.2 për qind).

Tabela 1: Disa tregues kryesorë për zonën e euros⁴ (ndryshim në % kundrejt periudhës paraardhëse)

Treguesi	Korrik 01	Gusht 01	Shtator 01
Indeksi i besimit ekonomik	-0.4	-0.6	0.0
Treguesi i besimit konsumator	5	3	2
Treguesi i besimit industrial	-2	-3	-4
Treguesi i besimit të ndërtimit	13	12	15
Treguesi i klimës së biznesit	-0.4	-0.5	-0.6

Rritja ekonomike e **Gjermanisë** ndaloi në tremujorin e tretë duke treguar se vendi, pas ngjarjeve të 11 shtatorit, i humbi shpresat për një rimëkëmbje që dukej se kishte nisur gjatë verës. Eksportet, porositë për fabrikat dhe prodhimi industrial ranë në muajin shtator ndërkohë që papunësia u rrit në mënyrë të konsiderueshme duke arritur nivelin 9.5 në muajin tetor. Megjithë uljet në normat e interesit, besimi i konsumatorit dhe ai i biznesit vazhdojnë të shënojnë nivele të ulëta. Në përgjigje të rënies së vazhduar në SHBA, parashikimet e Qeverisë Gjermane për rritjen ekonomike të vitit 2001 mbeten në nivelin 0.75 për qind ndërsa për vitin 2002, 1-1.5 për qind.

Megjithëse lajmet nga **ekonomia britanike** nuk janë shumë shqetësuese, muaji shtator ka regjistruar një ngritje prej 0.1 për qind në shifrën e papunësisë e cila arriti në nivelin 5.1 për qind. Rënia prej 0.5 për qind në çmimet e shtëpive është parë me shqetësim për shkak se tregu i shtëpive shihet si pasqyruar i drejtpërdrejtë i sigurisë për vendet e punës. Për më tepër, në shtator u regjistrua një rënie prej 25 për qind -- më e madhja prej një dekade e reklamimeve për vende pune në shtypin britanik. Banka e Anglisë, në fillim të muajit nëntor, uli normën e interesit me 0.5 pikë përqindjeje duke dashur t'i paraprijë një ngadalësimi ekonomik. Sidoqoftë, ajo ka të ngjarë të tregojë më tepër kujdes përpara uljeve të mëtejshme, për të evituar prirjet inflacioniste në ekonomi.

Në muajin shtator **Franca** ka vazhduar të përballet, për të pestin muaj rresht, me problemin e papunësisë, e cila ka arritur nivelin 9.1 për qind. Ndërkohë që besimi i biznesit vazhdon të bjerë, ai i konsumatorit ka shfaqur një rritje të lehtë në muajin tetor.

Porositë për mallra industriale **në Itali** ranë me 6 për qind në shtator ose 10 për qind në krahasim me një vit më parë. Besimi i prodhuesve në shtator ka shënuar

³ Të dhënat për shtetet e zonës euro janë marrë nga PriceWaterhouseCoopers, Global, Country Briefings.

⁴ Burimi: Buletini mujor i Bankës Qendrore Europiane, Tetor 2001.

shifrën më të ulët për katër dekadat e fundit. Porositë për eksporte dhe porositë për konsum të brendshëm kanë rënë me përkatësisht 3.3 dhe 8.5 për qind gjë që do të thotë që të paktën për tremujorin e katërt, perspektiva nuk duket shumë optimiste. Duke qenë se Italia është një nga konsumatorët më të mëdhenj të eksporteve shqiptare, pavarësisht nga vendi i vogël që ato zënë në importet totale të Italisë, ka të ngjarë që rënia e kërkesës për konsum të brendshëm, të reflektohet në një kërkesë më të ulët të vendit edhe për mallra të importuar nga Shqipëria.

I .1. Normat e interesit të Bankave Qendore

Gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, Rezerva Federale e SHBA i ka ulur normat e interesit tre herë. Herën e parë me 0.25 pikë përqindjeje duke i çuar nga 3.75 në 3.5 për qind. Herën e dytë me 0.5 pikë përqindjeje (duke arritur në 3 për qind) dhe të tretën po me 0.5 pikë përqindjeje (2.5 për qind). Ulja e tretë për tremujorin u bë më datë 18 shtator, menjëherë pas hapjes së tregut të aksioneve në SHBA.

Banka Qendrore Europiane, në fillim të muajit nëntor, shpalli një ulje tjetër të normës së rifinancimit. Ulja u bë përsëri me 0.5 pikë përqindjeje duke e çuar normën e rifinancimit në nivelin 3.25 për qind. Kjo normë mbetet gjithësesi shumë më e lartë nga norma aktuale e rifinancimit të shpallur nga Sistemi i Rezervës Federale në SHBA. Kjo normë u ul për të tretën herë pas ngjarjeve të 11 shtatorit duke arritur nivelin 1.75 për qind. Sidoqoftë, politika monetare tani për tani, shihet si mjeti kryesor që mund të ndikojë në rritjen ekonomike, ndryshe nga politika fiskale. Kjo e fundit mendohet se do të shërbejë pikë së pari për të rritur besimin e konsumatorëve dhe të bizneseve.

I. 2. Ekonomia e rajonit

Deri në fillim të muajit shtator humbjet që ka pësuar **ekonomia maqedonase** nga konflikti i brendshëm llogariten në nivelin 790 milionë usd⁵. Humbjet më të mëdha janë regjistruar në sektorët e industrisë dhe të minierave (rreth 173 milionë usd), të ndjekur nga industria tekstile (60 milionë usd), industria metalurgjike dhe ajo energjitike (60 milionë usd) etj.. Rënia e prodhimit të brendshëm, gjatë periudhës së konfliktit, ka çuar në një ulje të eksporteve me 10 për qind, ndërsa pagat tepër të ulëta kanë rezultuar në reduktim të kërkesës së brendshme dhe rrjedhimisht të importeve me 25.9 për qind. Paga mesatare është pothuajse e pamjaftueshme për të përballuar shportën bazë të konsumit në të cilën vetëm çmimet e produkteve ushqimore janë rritur me 7.8 për qind.

⁵ Burimi: Agjencia e Informacionit të FYROM dhe Agjencia AIM.

Deficiti buxhetor ka arritur nivelin 240 milionë usd dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve qeveritare shkojnë për mbrojtje dhe për nevoja të ushtrisë. Kompanitë amerikane, gjermane dhe holandeze të tekstileve po lenë vendin për partnerë më të sigurt si Ish-Jugosllavia apo Ukrahina. Papunësia ka arritur shifra rekord ndërkohë që edhe ata pak të punësuar nuk paguhen rregullisht dhe nuk janë të siguruar. Ekonomia joformale ka lulëzuar duke parandaluar, në njëfarë mase, problemet e forta sociale.

Parashikimi i Qeverisë Turke për rritjen ekonomike të **Turqisë** gjatë vitit 2001 është –8.5 për qind ose përndryshe rënia më e madhe që nga viti 1945. Të rejtat e fundit nga Turqia i përkasin sektorit financiar. Ky sektor, i gjendur në vështirësi prej shumë kohësh, humbi kohët e fundit pesë banka, të cilat vazhdonin të operonin me humbje. Pas kërkesës së pasuksesshme, bërë nga Qeveria Turke me mbështetjen e FMN-së, për bashkimin apo shkrirjen e bankave të vogla dhe të mesme në një të madhe, u pa i domosdoshëm transferimi i këtyre bankave tek Fondi i Depozitave të Sigurimeve. Një ndër këto banka është Kent Bank e cila aktualisht zotëron 60 për qind të aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare. Sipas drejtorit të Bankës Kombëtare Tregtare në Tiranë⁶, kjo bankë do të shesë aksionet e zotëruara nga Kent Bank, gjë që gjithësesi nuk pritet të shkaktojë probleme për operimin e Bankës Kombëtare Tregtare në të ardhmen.

II. Ekonomia e brendshme

Të dhënat historike, dëshmojnë se, përgjithësisht, tremujorët e tretë ndër vite, ndikohen nga efektet sezonale (periudha pushimesh), fakt që argumenton, mungesën e lëvizshmërisë së lartë të aktivitetit ekonomik në këtë periudhë të vitit. Edhe tremujori i tretë i vitit 2001, nuk bëri përjashtim nga prania e këtij fenomeni. Për më tepër, që tremujori i tretë, përkoi pas një periudhe mjaft intensive të aktivitetit ekonomik, kryesisht në fushën e investimeve në infrastrukturë dhe pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në vend. Periudha në vijim, sidomos muajt korrik, gusht dhe pjesërisht edhe shtatori manifestoi shenja "lodhjeje" për agjentët ekonomikë në tërësi, duke qetësuar aktivitetin e tyre prodhues, tregtar, ndërtimor. "Qetësia" e muajit gusht u vijua me një riaktivizim të aktivitetit në sektorin shtetëror të ekonomisë në muajin shtator.

Vlerësohet se tremujori i tretë i vitit vazhdoi të karakterizohet nga një situatë e rënduar energjitike, efektet e së cilës, mund të shkaktojnë zhvillime në kahje të kundërt me rritjen, duke vënë në vështirësi, sidomos në terma afatgjatë, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e një rritjeje të vazhdueshme dhe pa kthime prapa.

⁶ Burimi: "BKT përsëri në shitje", Monitor 24 (26), Dhjetor, 2001.

Në përgjithësi, pritet që rritja e **prodhimit bujqësor** të jetë rreth një pikë përqindjeje më pak se sa parashikimi në fillim të vitit. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e reduktimit në rritjen e prodhimit në bujqësi ndërkohë që, prodhimi i agroindustrisë ka ruajtur nivele të kënaqshme rritjeje.

Megjithëse të dhënat për këtë degë janë të pjesshme si në kohë ashtu edhe në informacion të detajuar sipas nënaktiviteteve të saj, dëshmohet se për tremujorin e tretë të vitit 2001, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, prodhimi ka shënuar shifra të larta për disa produkte të agroindustrisë si: vaj, cigare, sapun, konserva etj.. Ndërkohë që rëniet në prodhim të disa prej produkteve, për periudhat krahasuese, janë shfaqur në mënyrë më të ndjeshme në prodhimin e miellit, bukës, ujit të gazuar dhe në disa nënprodukte të qumështit.

Rëniet në prodhimin e disa prej produkteve të përmendura më lart, ndoshta, kanë ardhur edhe për shkak të intensitetit më të lartë të importit të tyre që duke rritur ofertën në treg për këto produkte, ka ndikuar në rënien e prodhimeve vendase. Nga ana tjetër, përkeqësimi i situatës energjitike, mund të ketë sjellë, kufizim të aktivitetit prodhues, që pa dyshim është pasqyruar në nivele më të kufizuara prodhimi.

Tabela 2: Realizimi i prodhimit për disa nga produktet kryesor

Nr	Produkti	Njësia	Tremujori i tretë 2001	Tremujori i tretë 2000	Ndryshimi (T 3-2001/ T 3-2000 në %)
1	Miell	Ton	31415	46989	67
2	Bukë	Ton	14945	16269	92
3	Komposto	Ton	45	90	50
4	Reçel, Marmalatë	Ton	40	81	49
5	Konserva perime	Ton	209	46	454
6	Konserva peshku	Ton	230	283	81
7	Birrë	HI	45471	33457	136
8	Verë	HI	7929	1863	426
9	Likerna, pije	HI	6987	2851	245
10	Pije freskuese	HI	130792	117909	111
11	Ujë i gazuar	HI	70496	97309	72
12	Ujë natyral	HI	34038	27116	126
13	Djathë gjithsej	Ton	2126	2397	89
14	Kos	Ton	747	1280	58
15	Vaj ulliri	Ton	40	35	114
16	Vaj lule	Ton	3319	40	8298
17	Gjalp	Ton	73	81	90
18	Sallam, proshutë	Ton	1105	988	112
19	Cigare	Ton	39	3	1300
20	Duhan i fermentuar	Ton	1793	1266	142

Burimi: Ministria Bujqësisë dhe Ushqimit, dhjetor 2001.

Tabela 3: Parashikimi i prodhimit bujqësor i vlerësuar për vitin 2001 (në milionë lekë)

Emërtimi	Viti 2000	Parashikimi 2001	Në %
1. Bujqësia	192 977	199 127	103.2
2. Agroindustria	17 946	19 200	107.0
3. Peshkimi	1 668	1 750	104.9
Totali	212 591	220 277	103.6

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

Të dhënat për **prodhimin industrial në sektorin shtetëror** për tremujorin e tretë vazhdojnë të flasin për një ecuri me lëkundje, por që në fund të fundit, përvijon tendencën rënëse të këtij sektori dhe tkurrjen e vazhdueshme të tij.

Tabela 4: Indeksi i prodhimit industrial

(në % kundrejt vitit 1993)	2000	2001		
	T 3	T 1	T 2	T 3
Prodhimi industrial në volum	61.6	33.7	43.9	34.1
- Industria nxjerrëse	33.3	28.8	29.1	27.3
- Industria përpunuese	64.2	16.9	33.6	24.6
- Prodhimi i energjisë elektrike	98.5	117.8	116.5	88.9

Burimi: INSTAT, "Konjuktura", tremujori i tretë, 2001.

Në këtë tremujor, krahasuar me tremujorin paraardhës, rëniet e prodhimit janë evidente si në volum ashtu edhe për secilën degë të industrisë. Në volumin e përgjithshëm, prodhimi industrial ra me afro 22.3 për qind për periudhat krahasuese. Ndër të trija degët e industrisë, rëniet më "të forta" i kanë manifestuar industria përpunuese dhe ajo e prodhimit të energjisë elektrike, përkatësisht me 26.7 dhe 23.6 për qind. Prirje më të qëndrueshme ka manifestuar dega nxjerrëse e industrisë, megjithëse tendenca rënëse e prodhimit nuk mungon edhe në këtë degë.

Shifrat për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, dëshmojnë edhe një herë për situatën e vështirë në cilën gjendet kjo degë. Jo vetëm që spikat tendenca rënëse përgjatë gjithë vitit 2001, por rënia e theksuar në tremujorin e tretë të vitit 2001 në krahasim me atë paraardhës, përbën një fakt shqetësues, për ardhmërinë e saj dhe të të gjithë ekonomisë së vendit, të rritjes së prodhimit dhe sigurimit të një ekonomie pa presione të brendshme inflacioniste. Për më tepër që kur shifrat flasin për një rënie të prodhimit të energjisë elektrike nga njëri vit në tjetrin, faktori "energji elektrike", nuk përbën më një faktor me ndikim negativ të përkohshëm në ekonomi, por në të kundërt, ndikimi i tij është i përhershëm dhe me pasoja tashmë të përhapura në formë zinxhir, që mund të shndërrohet në faktor rritës për koston. Kështu, tremujori i tretë i vitit 2001 shënoi një rënie me rreth 10 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Edhe treguesi i **prodhimit mall të shitur**, flet për rënie të tij nga njëri tremujor në tjetrin. Kështu, tremujori i tretë shënoi një rënie me rreth 16.7 për qind në krahasim me një tremujor më parë. Edhe të dhënat për prodhimin mall të shitur të **K.E.SH.**-it, tregojnë se tremujori i tretë në krahasim me paraardhësin shënoi një rënie me rreth 18.75 për qind.

Tabela 5: Prodhimi mall i shitur (në miliardë lekë)

Sektorët	T-2 2001	T-3 2001	Ndryshimi 9 mujor 2001/2000 (në %)
Totali	4.8	4.0	83.1
Albpetrol Sh. A.	1.3	1.2	114.6
Armo Sh. A.	1.5	1.3	81.7
Servcom Sh. A.	0.023	0.022	59.9
K.E.SH. Sh. A.	1.6	1.3	71.8
Minierat	0.051	0.024	31.7
Industria	0.23	0.16	110

Burimi : Ministria Ekonomisë dhe Privatizimit, shtator 2001.

Të dhënat për **sektorin privat të ekonomisë**, mbështeten në disa tregues indirektë si, ai i investimeve, i kërkesës së brendshme, i tregtisë së jashtme dhe të dhëna të tjera të grumbulluara nga degë të ndryshme të këtij sektori. Tremujori i tretë, ka qenë më i qetë, dhe me një shpërndarje më normale të investimeve të kryera në këtë sektor. Vërehet që, **konsumi i çimentos** ka pësuar një rënie të theksuar në tremujorin e tretë në krahasim me paraardhësin me rreth 40.5 për qind. Për më tepër, ky është i një informacion që tregon se edhe **dega e ndërtimit**, vazhdon të mos njohë rritjet e kaluara, por një frenim të hapave, edhe për këtë tremujor. Ky fakt përforcohet edhe më shumë kur dihet se tremujorët e dytë dhe të tretë të viteve, janë periudha gjatë të cilave aktiviteti ndërtimor kryhet më me intensitet, fenomen, që nuk mbështetet nga të dhënat e disponueshme. Gjithashtu, ky aktivitet gjatë tremujorit të tretë është përballur me një kosto më të lartë se një tremujor më parë. Indeksi i kushtimit në ndërtim arriti 113.68 për qind apo 0.22 për qind më i lartë se periudha paraardhëse. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ai u rrit me 6.4 për qind. Edhe **konsumi i dukshëm i energjisë elektrike**, ashtu edhe siç është treguar më lart, ka ardhur në rënie, duke dëshmuar edhe një herë, se më shumë se çdo faktor tjetër, kjo rënie është shkaktuar nga krahu i ofertës më të ulët. Treguesit kryesorë të **tregtisë së jashtme**, paraqesin një tendencë jo shumë të qartë zhvillimi. Rënia e indeksit të mbulimit të importeve nga eksportet, në tremujorin e tretë në krahasim me ata paraardhësit, ka ardhur kryesisht për efekt të rënies së volumit të eksporteve në këtë tremujor. Në muajin gusht, vërehet një **konsum i konsiderueshëm i karburanteve**, rreth 3.1 herë më i lartë se muaji korrik, fakt që mund të argumentohet nga njëra anë me rritjen e lëvizshmërisë së njerëzve, kryesisht për qëllime pushimesh dhe nga ana tjetër me rritjen e përdorimit të gjeneratorëve që deri-diku kanë zëvendësuar konsumin më të ulët të energjisë elektrike.

Tabela 6: Ecuria e sektorit privat të ekonomisë, viti 2001

Treguesit indirektë	Njësia e matjes në:	2001			Korrik	Gusht	Shtator
		T1	T2	T3	2001	2001	2001
Investimet							
Importi i makinerive dhe i pajisjeve	Mld lekë	8.7	11.7	11.1	4.1	2.8	4.2
Konsumi i dukshëm i çimentos	mijë tonë	267	506.4	301	99	102	100
Kërkesa e brendshme							
Konsumi i energjisë elektrike	mln këh	502	502	468	164	163	159
Konsumi i karburanteve	mijë tonë	73.8	73.8	92.0	15.4	48.1	28.5
Importe pajisjesh elektroshtëpiake	mijë copë	10.8	16.5	13.4	3.2	4.8	5.4
Importe autoveturash	mijë copë	7.6	3.4	3.9	1.2	1.4	1.3
Tregtia e jashtme							
Totali i eksporteve	mld lekë	11.3	13.0	8.5	2.7	2.1	3.7
Totali i importeve	mld lekë	41.2	47.9	45.6	15.9	13.0	16.7
Eksport/Import	%	27.4	27.2	18.4	16.76	16.14	21.69

Burimi: INSTAT, "Konjuktura", tremujori i tretë, 2001.

Dega e transportit, ka paraqitur arritje të kënaqshme për treguesit e investimeve. Edhe tremujori i tretë ka vijuar të karakterizohet nga nivele të larta realizimesh, në krahasim me parashikimet për to.

Tabela 7: Ecuria e realizimit të investimeve për vitin 2001

Investimet	Realizimet kundrejt programit (në %)		
	T 1	T 2	T 3
Gjithsej	78.6	114.6	111.96
- Buxhetore	42.6	112.5	74.37
- Ndihma e kredi	101	116	146.38

Burimi: Ministria e Transporteve.

Struktura e investimeve në degën e transportit, ashtu si gjatë gjithë gjashtëmujorit të parë të vitit 2001, edhe gjatë tremujorit të tretë, ka qënë dukshëm në favor të transportit rrugor, me afro 77 për qind, ndonëse në nivele më të ulëta se në pjesën e parë të vitit. Kjo, për faktin se në tremujorin e dytë të vitit 2001, pati një përqëndrim shumë më të lartë të investimeve në infrastrukturën rrugore, më të lartë se çdo vit tjetër.

Treguesit e vëllimit të punës, në llojet e ndryshme të transporteve, kanë manifestuar një ecuri pak a shumë të qëndrueshme.

Tabela 8: Vëllimi i punës së ngarkim-shkarkimit (në mijë tonë fizikë)

Vëllimi i ngarkim-shkarkimit	6-mujori I 2001	Trem 3 2001
Hekurudha	91.1	66.5
Porte	1419.5	715.2
Gjithsej	1510.6	782.3

Burimi: Ministria e Transporteve.

Vërehet që vëllimi i punës së ngarkim-shkarkimit, ka arritur nivele më të larta në tremujorin e tretë, kryesisht në transportin hekurudhor, në të cilin është realizuar

rreth 73 për qind e vëllimit të punës të kryer gjatë gjithë gjysmës së parë të vitit 2001.

Tabela 9: Ecuria e transportit ajror në vitin 2001

Nr	Treguesit	Njësia e matjes	6-mujori I 2001	Tremujori 3 2001
1	Shoqëri ajrore	Shoqëri	10	10
2	Avionë gjithsej - Mbikalime	Avionë “	34629 32057	28086 26694
3	Transport udhëtarësh	Udhëtarë	204589	148021
4	Mallra dhe posta	Tonë	801	453

Burimi: Ministria e Transporteve.

Në transportin ajror vërehen nivele të larta të treguesve të punës, kryesisht në tremujorin e tretë të vitit, kjo edhe për shkak të ndikimeve sezonale: dihet tashmë që ky tremujor është më i ngarkuar me lëvizje të udhëtarëve e për pasojë edhe të mallrave e të avionëve.

II. 1. Sektori i jashtëm i ekonomisë

II. 1. 1. Llogaria korente

Bilanci i llogarisë korente për tremujorin e tretë të vitit 2001 është –84.2 milionë usd⁷. Në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar, kur bilanci ishte 27.4 milionë usd, llogaria korente ka paraqitje shumë më negative. Transaksionet totale të llogarisë korente për këtë tremujor kapën shifrën 832 milionë usd nga të cilat 374 milionë usd ishin të ardhurat dhe 458 milionë usd të dalat. Në krahasim me të njëjtat periudha të vitit të kaluar hyrjet janë 12.2 për qind më të ulëta ndërsa daljet 14.8 për qind më të larta. Këtu duhet theksuar se, ndërsa në daljet e llogarisë korente peshën më të madhe e mbajnë importet e mallrave (69 për qind), tek hyrjet pesha ndahet pothuajse në mënyrë të barabartë midis të ardhurave nga shërbimet dhe transfertave korente (me përkatësisht 35 dhe 37 për qind). Një ndryshim i tillë midis llogarisë korente të këtij tremujori dhe asaj të tremujorit të tretë të vitit të kaluar ka ardhur si pasojë e rritjes së importeve të mallrave me rreth 52 milionë usd, rënies së eksporteve me rreth 5 milionë usd dhe sidomos rënies së zërit ‘transferta korente’ me rreth 78 milionë usd. Bilancet lehtësisht pozitive të shërbimeve (11.5 milionë usd) dhe të të ardhurave (39.5 milionë usd) ndonëse më të lartë se për të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, nuk mund të kompensojnë rritjen e theksuar në importe dhe rënien e transfertave korente.

⁷ Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor, Bilanci i Pagesave.

II. 1.1.1. Tregtia e jashtme

Tregtia e jashtme gjatë tremujorit të tretë pati pikën e saj më të ulët në muajin gusht i cili regjistroi eksporte totale prej 14.8 milionë usd dhe importe prej 90 milionë usd. Muaji shtator shfaq shenja rritje të aktivitetit tregtar duke shënuar nivele më të larta jo vetëm se muaji paraardhës, por edhe se ato të shtatorit të vitit të kaluar. Importet totale të tremujorit rezultuan 316 milionë usd ndërsa eksportet 58.5 milionë usd. Shifra e importeve, për këtë tremujor, është 19.6 për qind më e lartë se e njëjta shifër për tremujorin e tretë të vitit 2000, ndërsa eksportet, mbi të njëjtën bazë krahasimi janë 7.8 për qind më të ulëta.

Tabela 10: Pesha dhe ecuria e disa grupmallrave në importet totale

Importet	Pesha ndaj totalit (%)	Ndaj Q2-01 (%)	Ndaj Q3-00 (%)
Makineri dhe pajisje	19	-2.4	75.3
Produkte minerale	13	6	13.8
Tekstile	9.5	-14.4	5.9

Rritja e madhe në importet e makinerive dhe të pajisjeve elektrike dhe mekanike në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2000, ka ardhur si pasojë e importeve të shtuara të makinerive dhe pajisjeve elektrike për tinguj, imazh televiziv etj. dhe sidomos gjeneratorëve elektrikë. Këta të fundit importohen në masë me afrimin e periudhës kur vendi vuan më tepër nga mungesa e energjisë elektrike.


Në krahun e eksporteve pesha mbahet ekskluzivisht nga grupmallrat tekstile dhe artikuj tekstile dhe veshje të kokës dhe këmbës. Ishte pikërisht rënia në eksportet e këtyre dy grupmallrave ajo që rezultoi në shifrën tepër të ulët të eksportit për muajin gusht.

Tabela 11: Pesha dhe ecuria e dy grupmallrave kryesore në eksportet totale

Eksportet	Pesha ndaj totalit (%)	Ndaj Q2-01 (%)	Ndaj Q3-00 (%)
Tekstile	47	-49.6	10.8
Veshje koke dhe këmbë	25	-44	3.4

Siç shihet eksporti i dy grupmallrave që përbëjnë bazën e eksporteve tona (eksporte të përpunimit aktiv) ka pësuar rënie të konsiderueshme ndaj tremujorit të dytë të këtij viti dhe një ngritje të lehtë në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Eksportet e tremujorit të tretë janë të krahasueshme me eksportet e të njëjtëve tremujorë për dy vitet e fundit, por mjaft më të ulëta nga ato të dy tremujorëve të parë të këtij viti.

Grafiku 1: Ecuria e eksporteve gjatë tre viteve të fundit (në milionë USD)



Gjatë muajve korrik dhe gusht eksportet në vendet e Komunitetit Europian kanë pësuar rënie ndaj muajve paraardhës ndërsa shtatori ka shënuar një ngritje të kësaj shifre.

II. 1. 1. 2. Shërbimet

Gjatë tremujorit në shqyrtim bilanci i shërbimeve, 11.5 milionë usd, rezultoi më pozitiv se ai i tremujorit paraardhës, 1.47 milionë usd, dhe më i lartë nga bilanci i tremujorit të tretë të vitit të kaluar, -0.4 milionë usd. Shërbimet e importuara kapën shifrën 121 milionë usd ndërsa ato të eksportuara 133 milionë usd. Si në hyrjet ashtu edhe në daljet e shërbimeve pesha më e madhe mbahet nga shërbimet e turizmit (përkatësisht 83 dhe 65 për qind). Të ardhurat nga turizmi janë rreth 12 për qind më të larta nga të ardhurat e tremujorit të tretë të vitit 2000, ndërkohë që shpenzimet për turizëm kanë ruajtur pothuajse të njëjtat nivele. Një zhvillim që duhet vënë në dukje për këtë tremujor është rritja e shërbimeve të komunikimit që eksportohen (6.4 milionë usd) me 36 për qind ndaj tremujorit paraardhës dhe me 73 për qind ndaj tremujorit të tretë të vitit të kaluar.

II. 1. 1. 3. Të ardhurat

Bilanci i të ardhurave gjatë këtij tremujori ka rezultuar pozitiv në nivelin 39.5 milionë usd ose 42.5 për qind më i lartë nga bilanci i tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Të ardhurat nga interesat mbi rezervat jashtë vendit kapën nivelin 20.5 milionë usd. Këto të ardhura, janë të krahasueshme me të ardhurat e një tremujori më parë por 68 për qind më të larta nga ato të tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Në një kohë kur normat e interesit në tregun ndërkombëtar shfaqin tendencë zbritëse, një rritje në shumën e mbledhur nga interesat mbi depozitat do të thotë shtim i depozitave jashtë vendit.

II. 1. 1. 4. Transfertat

Bilanci i transfertave korente për këtë tremujor kapi shifrën pozitive prej 109.9 milionë usd. Kjo shifër është rreth 20 milionë usd më e lartë nga ajo e tremujorit të dytë të këtij viti, por 52.2 milionë usd më e ulët nga ajo e të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Meqënëse dukuria e rënies së transfertave korente në krahasim me vitin e kaluar po vihet re për të dytin tremujor rradhazi, mund të supozohet që ngadalësimi ekonomik i vendeve europiane ka prekur, në njëfarë mase, të ardhurat nga puna e emigrantëve. Kjo për faktin se këto të ardhura përbëjnë pjesën dërrmuese (93 për qind) të transfertave korente.

II. 1. 2. Përmbyllëse

Llogaria korente, siç u bë e qartë që në fillim, e mbylli këtë tremujor me një bilanc disi më të përmirësuar nga ai i një tremujori më parë (-99.7 milionë usd) por shumë më negativ nga ai i të njëjtës periudhë të një viti më parë. Flukset hyrëse të kapitalit të këtij tremujori (61 milionë usd) kanë qenë shumë më të larta se ato të tremujorit paraardhës (28 milionë usd) dhe të atij të vitit të kaluar (20 milionë usd). Ajo që bie në sy është rënia, për të dytin tremujor rradhazi, e investimeve të huaja direkte. Këto investime janë rreth 46 për qind më të ulëta nga ato të tremujorit të tretë të vitit 2000 dhe 18 për qind më të ulëta nga ato të tremujorit paraardhës. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2001, në tregun shqiptar hyri operatori i dytë i telefonisë celulare (VODAFONE), fakt që ndikoi në rritjen e shifrës së investimeve të huaja direkte për këtë periudhë. Nga ana tjetër, privatizimi i Bankës së Kursimeve, që ishte parashikuar për këtë vit, është shtyrë për vitin në vijim. Për pasojë, realizimi i investimeve të huaja direkte për nëntëmujorin është 62 për qind e parashikimit vjetor duke qëndruar 13 pikë përqindjeje nën nivelin e programuar. Investimet e portofolit janë rritur me 13 milionë usd duke dëshmuar një tendencë rritëse gjatë këtij viti. Rezervat valutore të autoritetit monetar gjatë kësaj periudhe janë rritur me 29.2 milionë usd.

Tabela 12: Bilanci i Pagesave

Llogaritë (në milionë dollarë amerikanë)	2001	2001
	3M-II	3M-III
Llogaria Korente	-99.7	-84.2
Eksporti	87.6	58.5
Importi	-321.1	-312.5
Bilanci Tregtar	-233.5	-254.1
Shërbimet: Kredi	108.2	132.8
Shërbimet: Debi	-106.8	-121.3
Të ardhurat: Kredi	38.0	43.5
Të ardhurat: Debi	-1.9	-4.0
Transferta private pa shpërblim	90.4	109.9
Transferta shtetërore pa shpërblim	6.0	8.8
Llogaria Kapitale	27.8	61.2
Llogaria Financiare	54.0	0.0
Investime direkte	41.5	33.9
Investime portofoli	-6.3	-13.0
Kapitale të tjera	18.7	-22.8
Gabime dhe harresa neto	33.2	46.3
Bilanci i Përgjithshëm	15.3	29.2
Rezervat dhe zëra të lidhur me to.		
Mjetet e rezervës	-15.3	-29.2
Përdorim huash e kredish nga FMN	0.0	5.9

Në qoftë se ngadalësimi në ekonominë botërore vazhdon, atëherë ka të ngjarë që eksportet shqiptare drejt vendeve të BE-së të reduktohen. Nga ana tjetër, nëse rënia e çmimeve të mallrave bazë në tregun ndërkombëtar do të vazhdojë, ajo mund të përbëjë një faktor nxitës për rritjen e importeve të këtyre produkteve. Në mënyrë më të papërcaktuar ka të ngjarë të lëvizin prurjet e


emigrantëve pasi ato mund të pakësohen në rast të rënies së kërkesës për fuqi punëtore, sidomos asaj të përkohshme, në vendet fqinje gjë që shihet si përkeqësim i situatës së bilancit të pagesave të Shqipërisë. Por, nga ana tjetër, emigrantët që kthehen mund të sjellin me vete kursimet e tyre për t'i investuar në vend duke përmirësuar situatën e bilancit të pagesave. Edhe bilanci i aktivitetit të turizmit mund të përkeqësohet. Nga ana tjetër, situata në ekonominë botërore dhe në rajon, mund të luajë rol frenues për investimet e huaja direkte në vend.

III. Ecuria e kursit të këmbimit

Për sa i përket **zhvillimeve në tregun ndërkombëtar valutor**, tremujori i tretë i vitit 2001 u karakterizua nga një mbiçmim i monedhës europiane, që arriti kulmin në muajin shtator, pas sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kështu mbiçmimi i euros në këtë tremujor ishte rreth 1.95 për qind në krahasim me tremujorin e mëparshëm. Por, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar ky kurs pati një nënçmim prej 1.69 për qind. Niveli mesatar i kursit të këmbimit në muajin shtator arriti vlerën mesatare të muajit mars, 0.91, dhe në ditët e para pas ngjarjeve të 11 shtatorit ky kurs arriti në vlerat e larta të këtij fillim viti kur monedha europiane ishte në pozita shumë të forta.

Në vazhdim, në muajt tetor dhe nëntor kursi këmbimit filloi të bjerë përsëri, me rënien e efektit psikologjik të pasngjarjeve terroriste në SHBA, dhe në muajin nëntor zbriti përsëri nën kufirin 0.9, duke shënuar vlerën 0.888.

Grafiku 2: Ecuria kursit nominal të këmbimit euro/dollar




Zhvillimet në tregun e brendshëm valutor gjatë këtij viti kanë qenë normale deri në mesin e muajit nëntor të vitit 2001. Termi normal nënkupton faktin se ecuria e kursit ka ndjekur trendin normal të zhvillimit. Kështu, në tregun shqiptar


u konfirmua sjellja simetrike e kundërt e lekut kundrejt dy monedhave kryesore, dollarit amerikan dhe euros. Gjithashtu, në ecurinë e kursit të këmbimit, deri në fund të muajit shtator, vihen re dhe lëkundjet sezonale të periudhës së verës si rezultat i fluksit të të ardhurve nga jashtë vendit. Megjithatë, efektet sezonale nuk ishin të të njëjtit intensitet si të viteve të kaluara, por në nivele më të ulëta. Mbiçmimi i lekut, nuk u shfaq në mënyrë të dukshme, si një karakteristikë e pritshme e sjelljes së kursit të këmbimit në periudhat e verës.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001, dollari u nënçmua në krahasim me tremujorin e dytë të këtij viti. Kështu, në këtë tremujor leku u mbiçmua me 1.5 për qind kundrejt dollarit dhe u nënçmua me 0.22 për qind kundrejt euros.

Grafiku 3: Ecuria e kursit nominal të këmbimit lekë/euro dhe lekë/usd




Grafiku 4: Ecuria e IÇK dhe REER



Duke filluar nga mesi i muajit shtator, pas ngjarjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, leku filloi të ketë lëkundje jonormale në lidhje me monedhën


amerikane dhe atë europiane. Në atë periudhë pati një mbiçmim të lekut në lidhje me dollarin.

Grafiku 5: Ecuria kursit të këmbimit të euro/lek dhe usd/lek (shtator 2001)



Ky mbiçmim i lekut në raport me të gjitha valutat e tjera vazhdoi edhe në muajt e tjerë të vitit, por nga mesi i muajit nëntor u vu re një mbiçmim i dukshëm i lekut si ndaj monedhës amerikane, ashtu dhe ndaj asaj europiane. Ky fenomen nuk ishte normal me ecurinë simetrike të deriathershme të kursit të këmbimit (duke marrë parasysh edhe faktorët sezonalë).

Grafiku 6: Ecuria e kursit nominal të këmbimit lekë/euro dhe lekë/usd (nëntor 2001)



Pas një stabilizimi të përkohshëm në fund të nëntorit, u shfaq përsëri në fillim të muajit dhjetor fenomeni i mbiçmimit të lekut, madje me një intensitet më të lartë. Në mesin e muajit dhjetor leku arriti vlerën 136 lekë për një dollar amerikan. Arsyet e këtij fenomeni mund të jenë të ndryshme. Por, ndodhja në momentin kur po afrohet hyrja e euros fizike në qarkullim të bën të mendosh se leku shqiptar po përfiton në maksimum prej kësaj ngjarjeje.

Procesi i prezantimit të euros fizike, ashtu siç pritej dhe më parë, ka ndikuar në shtimin e ofertës së valutave të zonës së Euros, të cilat do të humbin të drejtën ligjore për të shërbyer si mjet pagese, pas muajit shkurt të vitit të ardhshëm. Kuptohet që qytetarët që i disponojnë ato do të duhet t'i konvertojnë në dollarë ose në lekë. Preferenca më e lartë për t'i këmbyer në lekë, ka ardhur si rezultat i ndryshimit të madh që ekziston në normat e interesit të vendosura nga bankat tregtare të depozitave në lekë dhe atyre në dollarë. Kjo e ka bërë lekun shumë më tërheqës se dollarin. Pritet që ky fenomen të mbizotërojë tregun e këmbimit edhe në fund të muajit dhjetor, edhe për arsyen e ekzistencës së faktorëve sezonalë që intensifikojnë veprimin e tyre në këtë periudhë të fundvitit. Kërkesa për lekë do të rritet akoma më tepër me futjen e monedhave të huaja nga emigracioni, fakt që do të çojë në mbiçmimin e tij.

Tabela 13 : Ecuria e kurseve mesatare të këmbimit

Kursi i këmbimit	Tremujori I	Tremujori II	Tremujori III	Muaji nëntor
USD/EURO	1.074	1.535	1.124	1.126
Lek/EURO	132.04	128.32	128.63	124.49
Lek/USD	142.97	146.86	144.58	140.16

IV. Tregu i punës

Situata në tregun e punës, megjithëse matet në praninë e një ekonomie joformale të vlerësuar si mjaft të përhapur në vendin tonë, ka vijuar me regjistrime të treguesve të përmirësuar edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001. Numri i të papunëve vazhdon të bjerë dhe argumenti kryesor për këtë fenomen mbetet: zgjerimi i sektorit privat të ekonomisë duke siguruar hapje të vendeve të reja të punës. Në këto kushte, norma e papunësisë nga tremujori i dytë në të tretin, ka shënuar ulje. Për periudhat krahasuese, numri i të papunëve ra me rreth pesë mijë vetë dhe shkalla e papunësisë u ul me 0.3 pikë përqindjeje.

Tabela 14: Treguesit e punësimit, viti 2001

Treguesit	T 1	T 2	T 3
Forca e punës (në mijë)	1283	1269	1261
Të punësuar gjithsej (në mijë):	1078	1077	1074
- Sektori shtetëror	198	197	194
- Sektori privat jobujqësor	119	119	119
- Sektori privat bujqësor	761	761	761
Të papunë (në mijë)	205	192	187
Norma e papunësisë (në %)	15.96	15.1	14.80

Burimi: INSTAT, "Konjuktura", tremujori i tretë, 2001.

Nga ana tjetër, pothuajse paralelisht me numrin e të papunëve, ka rënë edhe numri i të punësuarve (vetëm në sektorin shtetëror), me afro tre mijë vetë, fakt që nuk argumenton plotësisht rënien e shkallës së papunësisë, por që mbështet idenë se zgjerimi i punës në të zezë është evident.

Siç dihet, tremujori i tretë i vitit, është karakterizuar nga një nismë e qeverisë dhe e pushteteve lokale, për prishjen e ndërtimeve pa leje, fakt që, në njëfarë mënyre ka nxjerrë si të papunë një pjesë të madhe të “të ish – punësuarve”. Po kështu, në këtë tremujor, një pjesë e madhe e studentëve që mbarojnë studimet e larta, gjenden në tregun e punës, në mënyrë të drejtpërdrejtë, si kërkues të punës. Përballë këtyre dy fakteve të pamohueshme, numri i të papunëve njihet rënie të vazhdueshme. Ky paradoks i zhvillimeve në tregun e punës, vazhdon të jetë i ushqyer edhe nga paradoksi tjetër që prej mëse disa vitesh është vënë në dukje: ai i numrit konstant të të punësuarve në sektorin privat të ekonomisë.

V. Zhvillimet fiskale

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001, ekonomia shqiptare ka vazhduar të ecë në një klimë të kënaqshme të arritjes në treguesit fiskalë, falë përpjekjeve të autoriteteve përkatëse për vjeljen e të ardhurave dhe për kryerjen e shpenzimeve brenda kufijve të programuar. Zhvillimet e politikës fiskale, në përgjithësi, kanë rezultuar brenda kufijve të planifikuar duke mos ushtruar presione të forta mbi sistemin bankar për likuiditet.

V. 1. Të ardhurat buxhetore

Gjatë tremujorit të tretë ritmika e vjeljes së të ardhurave ka manifestuar një ecuri normale. Muaji gusht paraqiti një rënie të lehtë, fakt që mund të shpjegohet me situatën e përgjithshme më të qetësuar të aktivitetit ekonomik në vend. Sidoqoftë, në tremujorin e tretë, pati një rënie të vjeljes së të ardhurave në masën 7.2 për qind. E rëndësishme është që të ardhurat tatimore, ruajtën pothuaj të njëjtin nivel si edhe një tremujor më parë. Ndërsa, grupi i të ardhurave jotatimore, paraqiti rëniet më të theksuara, me afro 35 për qind nën nivelin e tremujorit të dytë. Niveli i ulët i realizimeve në këtë grup të ardhurash, është ndikuar kryesisht nga rënia e tyre nga institucionet buxhetore.

Struktura e të ardhurave buxhetore edhe këtë tremujor vazhdoi të jetë, në favor të të ardhurave tatimore, të cilat patën një peshë prej 68.7 për qind të të ardhurave totale. Ndërkohë që, në të ardhurat tatimore vetëm zëri i të ardhurave nga tatimet dhe doganat, zuri një peshë prej afro 98.5 për qind.

Tabela 15: Të ardhurat buxhetore në vitin 2001 (në miliardë lekë)

Treguesi	T 1 2001	T 2 2001	T 3 2001	Korrik 2001	Gusht 2001	Shtator 2001	Tetor 2001	Realizimi 10-mujor (në %)
Të ardhurat totale	29.8	35.8	33.2	11.5	10.6	11.1	11.6	97.8
- Të ardhura tatimore	21.4	22.9	22.8	7.5	7.5	7.8	9.2	100.2
-Të ardhura nga buxheti i pavarur	5.5	5.4	5.7	1.8	1.8	2.1	1.9	101.3
- Të ardhura jotatimore	3.0	7.4	4.8	2.2	1.3	1.3	0.4	84.3

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

V. 2. Shpenzimet buxhetore

Pamja e shpenzimeve buxhetore, manifestoi një rregullsi më të lartë në ritmikën e kryerjes gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001. Pas një periudhe mjaft intensive shpenzimesh të tremujorit paraardhës, kryesisht të atyre kapitale, duket se mënyra e kryerjes së tyre gjatë këtij tremujori, është normalizuar.

Tabela 16: Shpenzimet buxhetore në vitin 2001 (në miliardë lekë)

Treguesi	T 1 2001	T 2 2001	T 3 2001	Korrik 2001	Gusht 2001	Shtator 2001	Tetor 2001	Realizimi 10-mujor (në %)
Shpenzimet totale	35.8	48.4	43.7	15.9	13.5	14.3	11.6	92.8
- Shpenzime korente	31.2	34.9	33.8	12.5	10.6	10.7	10.5	97.8
- Shpenzime kapitale	4.5	12.2	9.9	3.6	2.7	3.6	1	87.7
- Kosto e ristrukt. të B.SH.	0.2	1.2	0.0	0	0	0.0	0	

Burimi: Zyra përfaqësuese e FMN në Tiranë.

Tremujori i tretë në krahasim me atë paraardhës, realizoi një nivel shpenzimesh më të ulët, në masën 9.7 për qind. Në muajin gusht, ashtu si edhe në të gjithë treguesit e tjerë të analizuar më parë, vihet re një rënie e kryerjes së tyre, ndoshta për efekt të rënies së aktivitetit ekonomik në tërësi në këtë periudhë të vitit. Argumenti më sipër për rënien e shpenzimeve totale, mbështetet edhe në të dhënat e shpenzimeve sipas zërave, ku shpenzimet kapitale të muajit gusht, janë pakësuar me rreth një miliardë lekë në krahasim me dy muajt e tjerë të tremujorit.

Realizimi i shpenzimeve përkundrejt parashikimit për to (në nivel dhjetëmujor), pasqyron një devijim nën vlerën e programuar me rreth 7.2 për qind. Në këtë mosrealizim, shqetësues është fakti që, përsëri janë shpenzimet kapitale ato që paraqesin nivelin më të ulët të këtij realizimi, me rreth 12.3 për qind nën parashikimin dhjetëmujor për to. Ky fenomen, i cili mund të quhet "historik i

përvitshëm”, mbart në vetvete rrezikun e përqëndrimit të shpenzimeve në fund të vitit, moment që nevojat e ekonomisë për likuiditete nga sistemi bankar shtohen, për pasojë rritet vështirësia e tij për t’i përballuar ato. Nga ana tjetër, shtohen presionet e ardhshme inflacioniste në ekonomi, që reflektohen në shifra më të larta të inflacionit në muajt e parë të vitit në vijim.

Duke gjykuar edhe mbi shifrën e muajit tetor, e cila kapi një vlerë mjaft të ulët, jemi të mendimit që ruajtja e ritmikës së rregullt të kryerjes së këtij grupi shpenzimesh, duhet të tërheqë vëmendjen e organeve kompetente, për efektet negative që ajo përçon në treguesit kryesorë makroekonomikë.

Struktura e shpenzimeve sipas zërave, në tremujorin e tretë, vazhdon të qëndrojë në favor të shpenzimeve korente, në masën 77.3 për qind të totalit të shpenzimeve. Në krahasim me një tremujor më parë, vërehen zhvendosje drejt shpenzimeve korente, me afro 5.2 pikë përqindjeje më shumë. Ndërsa në drejtim të kundërt, zhvendosja është kryer për grupin e shpenzimeve kapitale, të cilat në këtë tremujor kanë rezultuar në nivel më të ulët në strukturën e përgjithshme të shpenzimeve, krahasuar me tremujorin paraardhës (2.5 pikë përqindjeje më pak). Ndoshta këto ndryshime nuk duhen konsideruar si të rastit, për faktin e thjeshtë të përqëndrimit të lartë të shpenzimeve kapitale gjatë tremujorit paraardhës.


Tabela 17: Struktura e shpenzimeve

Treguesi	T 2 2001	T 3 2001	Ndryshimi (T2-T3)
Shpenzimet totale	100.0	100.0	0
- Shpenzime korente	72.1	77.3	-5.2
- Shpenzime kapitale	25.2	22.7	2.5
- Kosto e ristrukt. të B.SH.	2.7	0.0	2.7

V.3. Deficiti buxhetor

Deficiti buxhetor për tremujorin e tretë shënoi shifrën e 10.4 miliardë lekëve, duke rënë me afro 17.4 për qind në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2001. Rreth 51 për qind e tij u financua nga burime të brendshme dhe pjesa tjetër nga burime të huaja. Të ardhurat nga privatizimi, në financimin e brendshëm zunë 85 për qind të totalit të tij. Sidoqoftë, vërehet një mosrealizim i dukshëm i deficitit buxhetor si dhjetëmujor duke qëndruar me rreth 22 për qind më poshtë se sa parashikimi për të.

Grafiku 7: Ecuria mujore e deficitit buxhetor dhe financimit të brendshëm të tij për periudhën 2000-2001




Pritet që deri në fund të vitit deficiti buxhetor të arrijë nivelin 9.4 për qind të PBB-së nga i cili 2.1 për qind e PBB-së do të jetë i financuar me të ardhurat e privatizimit dhe 2.8 për qind e PBB-së nga ana e sistemit bankar.

VI. Zhvillime në çmimet e konsumit

Në mënyrë të vazhdueshme, në pothuajse tërë vitin, inflacioni erdhi duke u rritur, duke arritur nivelin më të lartë në muajin korrik, prej 5.6 për qind, nivel i cili kalonte ndjeshëm kufirin e sipërm të intervalit objektiv prej 4 për qind. Ndërsa në dy muajt vijues inflacioni vjetor ka ardhur në reduktim për të arritur në fund të muajit tetor në 1.8 për qind. Ndërkohë që në muajin nëntor 2001, ai regjistroi shifrën e 2.8 për qind në nivel vjetor, apo 1.9 për qind si ndryshim mujor.

Grafiku 8: Norma vjetore e inflacionit dhe objektiv



Periudha korrik-shtator 2001, në ndryshim nga e njëjta periudhë e vitit 2000, por edhe nga tendenca e përshtuar prej tremujorëve të tretë të viteve të kaluara, paraqiti disa veçori që u manifestuan në:

- ndikimin më të pakët të efekteve sezonale, të stinës së verës. Të njëjtën veçori paraqiti edhe kursi i këmbimit të monedhës së vendit kundrejt dollarit amerikan dhe euros. Në tërësi, leku mbiçmohet në stinën e verës për t'u nënçmuar më pas. Në fakt, ka patur një zhvendosje të kësaj sjelljeje, ku leku shqiptar nuk u mbiçmua me të njëjtin intensitet gjatë periudhës së verës, përkundrazi në momente të caktuara u nënçmua. Ndërkohë, stina e vjeshtës solli mbiçmim të lekut, ndryshe nga vite të mëparshme si pasojë e nënçmimit të dollarit amerikan në tregjet botërore pas sulmit të 11 shtatorit dhe më tej si pasojë e afrimit të datës së hyrjes në qarkullim të euros fizike;
- ekzistencën e një sërë faktorëve shock të krahut të ofertës, të cilët pasuan njeri-tjetrin duke u shndërruar në faktorë me veprim të përhershëm. Më të spikaturit ndër këta faktorë kanë qenë: konflikti në Maqedoni dhe bllokimi i importeve, sidomos i frutave dhe perimeve, rritja e shpallur e pagave buxhetore dhe pensioneve në muajin korrik, përqëndrimi i shpenzimeve buxhetore të gjashtë muajve të parë të vitit, në muajt maj e qershor apo reduktimi i prodhimit bujqësor të vendit;
- pritsmëri për rritje të presioneve inflacioniste për pjesën e mbetur të vitit, sidomos nën ndikimin e krizës energjitike dhe të rritjes së çmimit të energjisë elektrike nga prezantimi i sistemit të ri dytarifor të pagimit. Gjithashtu, këto presione mund të shtohen edhe për efekt të festave të fundvitit, periudhë ku zakonisht rriten ndjeshëm çmimet.

Tabela 18: Seritë mujore të normës së inflacionit (në %)

Muajt	1998	1999	2000	2001
Janar	3.46	0.91	0.63	-1.30
Shkurt	1.81	-0.61	-0.6	-1.30
Mars	1.16	-0.29	-1.11	0.30
Prill	1.61	0.01	0.72	0.85
Maj	-0.19	-0.64	0.67	0.20
Qershor	-1.74	-2.28	-2.1	-0.70
Korrik	-2.01	-1.30	-2.7	-2.20
Gusht	0.41	-0.28	0.39	-1.00
Shtator	1.45	0.10	1.7	1.10
Tetor	0.26	0.39	1.3	-0.45
Nëntor	0.21	0.78	0.7	1.9
Dhjetor	2.05	2.25	4.6	

Burimi: INSTAT.

Tabela 19: Kategori të ndryshme të inflacionit vjetor për vitin 2001

Kategoritë (në %)	2000	2001										
	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
IÇK	4.20	2.53	1.46	2.89	3.02	2.54	4.04	5.61	4.14	3.53	1.79	2.83
Inflacioni bazë	-0.94	-0.94	-1.15	-0.68	-0.27	-0.04	-0.04	0.04	-0.21	0.05	-0.28	0.60
Inflacioni (përfshirë Fruta & Perime)	0.15	0.09	-0.20	0.64	-0.08	0.50	0.41	0.76	0.17	0.13	-0.29	1.38
IÇK (Grupi "Ushqim, pije & duhan" = 50 %)	2.19	1.12	0.74	1.59	1.83	1.56	2.49	3.66	2.61	2.12	1.00	1.51

Duke iu referuar zhvillimeve më të fundit në inflacion, rezultoi se inflacioni vjetor, në fund të muajit tetor, arriti në nivelin 1.8 për qind duke shënuar një reduktim mujor prej 0.45 për qind, shifër që konsiderohet si një zhvillim i veçantë në inflacion: seria kohore e muajve tetorë të kaluar nuk ka njohur ndonjëherë vlera negative të inflacionit mujor. Reduktimi i inflacionit në muajt shtator e tetor mendohet se ka ardhur si pasojë e qëndrueshmërisë (me kah mbiçmimi) të monedhës së vendit, e pranisë në treg të prodhimeve të stinës së vjeshtës, e reduktimit të përgjithshëm të çmimeve të mallrave në tregjet botërore, "qetësimit" të intensitetit të kryerjes së shpenzimeve buxhetore, të cilat siç kemi theksuar dhe më parë mendohet se japin një efekt të vonuar prej rreth tre muajsh. Ndërkohë, tendenca rritëse e inflacionit, e parashikuar tashmë nga banka qendrore, për muajt në vijim u vërtetua edhe në shifrën e faktuar të inflacionit të muajit nëntor 2001, ku inflacioni vjetor shënoi shifrën 2.8 për qind dhe ai mujor 1.9 për qind.

Pra, dy nga momentet e veçanta në drejtim të inflacionit, paraqiten në muajt korrik dhe tetor. Muaji korrik me vlerën maksimale 5.6 për qind dhe muaji tetor njohu një shifër të paparë ndonjëherë në historinë e serisë së inflacioneve të tetorëve që prej vitit 1993, një vlerë negative.

Nga ana tjetër, inflacioni bazë dhe ai i matur me një peshë të reduktuar të grupit "ushqim, pije dhe duhan"⁸, në mënyrë të vazhdueshme kanë qenë në nivele të ulëta, megjithatë, ata kanë patur tendencën e shfaqur nga IÇK-ja, për më tepër janë këto kategori inflacionesh që deri-diku përcaktojnë sjelljen e indeksit të çmimeve të konsumit.

Në këto kushte, Banka e Shqipërisë gjykon se, pavarësisht kapërcimeve të tilla, gjendja është disi e normalizuar, dhe pritshmëritë e saj për inflacionin, deri në fund të vitit nuk do të kalojnë vlerën 2-3 për qind. Kështu, politika monetare e saj do të vazhdojë të ruajë të njëjtin qëndrim, atë neutral.

Sidoqoftë, situata e tremujorit të tretë krahasuar me atë të tremujorit paraardhës, flet për ngadalësim të mëtejshëm të ritmit të rritjes në sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë së vendit si: në bujqësi, në

⁸ Këto pesha kanë rezultuar nga vrojtimi i fundit i "Buxhetit të Familjes", viti 2001.

ndërtim, në prodhim, në aktivitetin e tregtisë së jashtme etj.. Duke shtuar edhe faktin se, aktualisht ambienti makroekonomik vazhdon të përballet edhe me dy probleme tepër të mprehta: ashpërsimin e mëtejshëm të krizës energjitike dhe ngadalësimin e përgjithshëm të ekonomisë botërore, Banka e Shqipërisë vlerëson se arritja e objektivit për rritjen e PPB-së deri në fund të vitit 2001, me 7.3 për qind, mund të vihet në vështirësi.

VII. Zhvillimet monetare

VII. 1. Zhvillimet në kërkesën për para

Rritja e kërkesës për para gjatë tremujorit të tretë ka bërë që ekonomia shqiptare të thithë një rritje të ofertës monetare përtej parashikimeve fillestare, duke mos e shndërruar atë në çmime më të larta për konsumatorët.

Rritja mujore e kërkesës për para arriti pikun në muajin gusht (1.66 për qind) dhe, më pas, bie lehtë në muajin shtator (1.13 për qind). Rritjen kryesore në kërkesën për para për muajin gusht e përbën rritja e mjeteve valutore neto, kurse muaji korrik dhe shtator patën zhvillime më të rëndësishme në kredinë e brendshme.

VII.1.1. Mjetet valutore neto

Edhe gjatë tremujorit të tretë, pozicioni valutor i sistemit bankar u përmirësua më tej. Mjetet valutore neto u rritën me 4.38 për qind në krahasim me tremujorin e dytë. Rritje kanë patur si mjetet valutore të Bankës së Shqipërisë, të cilat janë rritur me 2.4 miliardë lekë, ashtu dhe të bankave tregtare të cilat janë rritur me 4.1 miliardë lekë.

Rritja e mjeteve valutore neto të sistemit është shoqëruar me mbiçmimin e vlerës së lekut në tregun valutor. Gjatë këtij tremujori leku është mbiçmuar me 4.6 për qind ndaj dollarit amerikan, duke kaluar nga 148.6 lekë/usd në fund të qershorit, në 141.7 lekë/usd në fund të shtatorit. Mbiçmimi i lekut ka një karakter sezonal në stinën e verës. Ai ndikohet nga rritja e dërgesave të emigrantëve dhe përmirësimi i bilancit të llogarisë korente në këtë periudhë.

Duke marrë parasysh edhe këtë mbiçmim të lekut, rritja në terma realë e mjeteve valutore neto të sistemit është edhe më e madhe. Në tabelën e mëposhtme paraqitet rritja e mjeteve valutore neto të sistemit, e shprehur në lekë dhe në usd.

Tabela 20: Ndryshimi në përqindje i mjeteve valutore neto, (në lekë dhe në usd)

	Tremujori i dytë		Tremujori i tretë	
	në dollarë	në lekë	në dollarë	në lekë
Banka e Shqipërisë	2.43	3.00	8.17	2.87
Bankat tregtare	-6.68	-2.80	9.66	6.29
Sistemi bankar	-1.77	0.36	8.82	4.38

Rritja e mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë ka ardhur kryesisht nga rritja e rezervës së saj valutore me 45 milionë usd, ndërsa rritja e mjeteve valutore neto të bankave tregtare buron nga rritja e depozitave në valutë në sistem. Rritja e këtyre depozitave nuk i vihet plotësisht në dispozicion agjentëve ekonomikë vendas, por në një masë të madhe, del përsëri jashtë vendit, në formën e depozitave me bankat e huaja.

Rritja e mjeteve valutore neto ka qenë vazhdimisht më e madhe se parashikimi i programit dhe është burimi kryesor i rritjes së ofertës monetare.

VII. 1.2. Mjetet e brendshme neto

Kërkesa e brendshme e ekonomisë për para edhe gjatë tremujorit të tretë vazhdon të ruajë të njëjtën strukturë si dhe në muajt e mëparshëm, ku pretendimet ndaj qeverisë zënë 88 për qind të totalit të kërkesës së brendshme dhe kreditimi ndaj ekonomisë zë 12 për qind.

VII. 1.2.1. Kredia për qeverinë

Në tremujorin e tretë kemi një rritje të konsiderueshme të këtij zëri krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Rritja e shpenzimeve buxhetore në muajt e verës dhe përdorimi i të ardhurave të privatizimit bëri që qeveria t'i drejtohej më shumë sistemit bankar për mbulimin e shpenzimeve të saj. Pretendimet neto ndaj qeverisë, të matura sipas programit u rritën me 4.9 miliardë lekë, kundrejt një rënieje prej 2.6 miliardë lekësh në tremujorin e dytë.

Gjithashtu, në muajin korrik, pati një rritje prej 5.5 miliardë lekësh të pretendimeve të bankave tregtare si pasojë e riskedulimit të borxhit të vjetër të qeverisë për Bankën e Kursimeve dhe Bankën Kombëtare Tregtare në kuadrin e privatizimit të këtyre bankave. Shpërndarja e portofolit të bonove të thesarit shënoi një ndryshim në rritje të këtij portofoli të bankave tregtare me 4 miliardë lekë dhe ulje për të njëjtën vlerë të portofolit të Bankës së Shqipërisë. Kjo u bë nëpërmjet një transaksioni me të drejta të plota në të cilin Banka e Shqipërisë shiti 4 miliardë lekë bono thesari nga portofoli i saj. Qëllimi i këtij transaksioni ishte ulja e likuiditetit të tepërt në sistemin bankar, i cili ushtronte presion në uljen e normave të interesit.

VII.1.2.2. Kredia për ekonominë

Teprica e kredisë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001 u rrit me 2.5 miliardë lekë krahasuar me fundin e muajit qershor 2001. Ky ndryshim ishte efekt i rritjes së kredisë së re, niveli i të cilës gjatë këtij tremujori arriti në 11.4 miliardë lekë dhe i shlyerjeve në masën 8.9 miliardë lekë.

Pjesa që zë krediti për ekonominë në kërkesën për para, ka ardhur duke u rritur gjatë vitit 2001. Ky tregues përbën një kthesë të aktivitetit të bankave në drejtim të investimit më të frutshëm të burimeve të tyre, në kreditimin e ekonomisë. Në fund të shtatorit 2001, kredia për ekonominë përbën 8,6 për qind të kërkesës për para.

Tabela 21: Disa tregues të kredisë për ekonominë

Treguesit	1999	2000	shtator '01
Oferta e parasë (në miliardë lekë)	292.9	328.1	362.5
Kredia e brendshme (në përqindje ndaj M3)	80.3	76.3	70.5
-Kredia për qeverinë (në përqindje ndaj M3)	73.5	68.4	61.9
-Krediapër ekonominë (në përqindje ndaj M3)	6.8	7.9	8.6
Kredia për ekonominë (në përqindje ndaj PBB)	3.9	4.8	5.2
Kredia për ekonominë (në përqindje ndaj aktiveve)	9.4	9.5	10.4
Raporti kredi/depozita (në përqindje)	9.4	11.3	12.2

Pesha e kredisë për ekonominë ndaj treguesve të tjerë makroekonomikë dhe financiarë është në rritje. Rritja e kësaj peshe ndaj totalit të aktiveve të bankave dhe ndaj depozitave tregon për një rritje të shkallës së ndërmjetësimit të sistemit bankar, duke e përmbushur më mirë rolin e tij në kanalizimin e kursimeve të ekonomisë në financimin e investimeve fitimprurëse. Kredia për ekonominë ka patur një rritje më të shpejtë se kredia për qeverinë dhe pesha e saj ndaj PBB ka qenë në rritje të vazhdueshme.

Edhe gjatë tremujorit të tretë, kreditimi i ekonomisë vazhdon të ruajë të njëjtat karakteristika, si për sa i përket strukturës kohore të tij, sektorëve të ekonomisë që përfitojnë më shumë dhe monedhës në të cilën akordohet kredia. Siç është trajtuar dhe në analizat e tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2001, përsëri (i) kredia afatshkurtër përbën pjesën më të madhe të tepricës dhe të kredisë së re të akorduar, (ii) ritmi i rritjes së kredisë në valutë është shumë herë më i lartë se ai në lekë dhe, (iii) mbizotëron kreditimi i sektorit privat kundrejt sektorit të ndërmarrjeve shtetërore.


Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2001, Banka e Kursimeve kaloi pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive rreth 85 për qind të tepricës të kredisë. Kjo u shoqërua

me reduktimin e tepriçës së kredisë të sistemit me 6.1 miliardë lekë. Ndërkohë, tregu i kredive është zgjeruar me pjesëmarrjen edhe të Bankës Kombëtare Tregtare e cila lëvroi kreditë e para në gusht, në shumën 15 milionë lekë.

VII. 2. Oferta monetare dhe objektivat e Bankës së Shqipërisë


Norma vjetore e rritjes së ofertës monetare, në tremujorin e tretë, vazhdoi të jetë e lartë. Në fund të muajit shtator, norma vjetore e rritjes së saj ishte 16.3 për qind.

Grafiku 9: Normat vjetore të rritjes së agregatëve monetarë



Rritje të ndjeshme, gjatë këtij tremujori, ka patur paraja jashtë bankave, kryesisht në përgjigje të rritjes së shpenzimeve qeveritare gjatë kesaj periudhe. Po kështu, rritje kanë patur edhe depozitat në valutë, duke e rritur peshën e tyre në ofertën monetare me 0.7 pikë përqindjeje, nga 20.9 për qind në qershor në 21.6 për qind shtator.

Grafiku 10: Përbërësit e ofertës monetare



Rritja e depozitave në lekë ka qenë më e kufizuar në terma relative, megjithë stabilitetin e normave të tyre të interesit. Rritja e tyre është vetëm 4.4 miliardë

lekë, kundrejt rritjes prej 5 miliardë lekësh të depozitave në valutë dhe parasë jashtë bankave.

Megjithë rritjen e shpejtë të parasë jashtë bankave në këtë periudhë, baza monetare është rritur me vetëm 0.7 miliardë lekë. Kjo ka ardhur si pasojë e uljes progresive të nivelit të rezervave të tepërta në sistem, niveli i të cilave, në fund të shtatorit, ishte 1.1 miliardë lekë kundrejt 5.7 miliardëve që ishte në qershor.

Megjithë rritjen e shpejtë të ofertës monetare, Banka e Shqipërisë ka përmbushur objektivat e saj sasiorë.

Tabela 22: Realizimi i objektivave sasiorë gjatë vitit 2001 (ndryshimi nga objektivi)

Objektivat	Mars	Qershor	Shtator
Rezervat ndërkombëtare neto të B. Sh. (në mld lekë)	18.3	12.8	28.2
Mjetet e brendshme neto të B.Sh. (në mld lekë)	-6.2	4.3	-1.2
Kredia neto e sistemit bankar për qeverinë (në mln usd)	-7.5	-17.6	-15.9

Kështu, ajo ka kontrolluar nivelin e likuiditetit në treg duke respektuar kufirin e sipërm të mjeteve të brendshme neto të saj. Rezervat ndërkombëtare neto të Bankës së Shqipërisë janë rritur më tej, duke qenë mbi objektivin e poshtëm të tyre dhe kredia e sistemit bankar për qeverinë është më e ulët se objektivi.

VIII. Normat e interesit dhe tregjet financiare

Banka e Shqipërisë, në tremujorin e tretë, ndërmori një politikë shtrënguese monetare, duke rritur me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjeve. Rritja e normës së interesit të repove, që shërben si norma referencë bazë e tregut të parasë, u bë për të frenuar rënien e mëtejshme të nivelit të normave të interesit si dhe për të ndihmuar në vënien nën kontroll të inflacionit.

VIII. 1. Normat e interesit në tregun e parasë

Zhvillimet në tregjet financiare gjatë këtij tremujori e në vazhdim e reflektuan këtë ndryshim të kursit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë. Sinjali i politikës së Bankës së Shqipërisë u transmetua direkt në tregun ndërbankar dhe në tregun e letrave me vlerë, ku u evidentua një rritje e normave të interesit për të tre tipet e maturiteteve.

Tregu i letrave me vlerë, i identifikuar me tregun primar të bonove të thesarit, vazhdon të ruajë të njëjtat karakteristika lidhur me strukturën dhe shkallën e

konkurrencës në të. Ky treg vazhdon të jetë i dominuar nga Banka e Kursimeve, e cila luan rolin kryesor në përcaktimin e normës së interesit të këtij tregu.


Vëllimi i emetimeve në këtë treg, në fund të shtatorit 2001, ka patur ulje krahasuar me muajin korrik, i cili shënoi nivelin më të lartë që nga muaji prill. Normat e interesit kanë shënuar rritjen më të lartë gjatë muajit shtator. Krahasuar me fillimin e periudhës ato kanë ndryshuar pothuajse me 0.5 pikë përqindjeje, duke reflektuar rritjen në normën e interesit të repove, nivelin e rezervave në sistem dhe pritjet inflacioniste të operatorëve të tregut.

Tabela 23: Yield-i në tregun primar në përqindje

Muajt	3 mujore	6 mujore	12 mujore
Korrik	7.49	9.24	9.95
Gusht	7.74	9.38	10.14
Shtator	7.95	9.55	10.49

Përdorimi i instrumenteve lehtësuese të ofruara nga Banka e Shqipërisë është në rritje. Niveli kumulativ i depozitave njëditore, në tremujorin e tretë, arriti 101,5 miliardë lekë, nga 86,2 miliardë lekë në tremujorin e dytë. Normat e interesit të tregut ndërbankar luhaten brenda brezit të krijuar nga depozita dhe kredia njëditore, nga 4.7 në 7.5 për qind.

Grafiku 11: Normat e interesit në tregun e parase⁹



⁹ Në grafik janë pasqyruar normat e interesave në fund të muajve.

Vëllimi i tregtimit në tregun ndërbankar, gjatë tremujorit të tretë, ka qenë 6,85 miliardë lekë ose 3,6 miliardë lekë më i lartë se vëllimi i transaksioneve në këtë treg gjatë tremujorit të dytë të vitit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vëllimi i transaksioneve është rreth 6,5 herë më i lartë gjë që tregon për një tendencë pozitive të sjelljes së bankave në tregun e parasë.

Tabela 24: Norma mesatare e interesit në tregun ndërbankar

Muajt	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Interesi	6.66	6.96	6.12	6.06	6.48	5.39

Diferenca midis *yield*-it të bonove të thesarit dhe normës së interesit për depozitat në lekë, e cila përbën një tregues të kostos së ndërmjetësimit të sistemit bankar, paraqitet me tendencë të lehtë rritëse, për të tre afatet e maturimit. Rritja e normave të interesit të bonove të thesarit, në një kohë që normat e interesit të depozitave në lekë kanë qenë relativisht konstante, ka ndikuar në rritjen e këtij treguesi. Nevojat e qeverisë për fonde ka bërë që niveli i emetimeve të jetë më i lartë se niveli i maturimeve të bonove të thesarit në ankandet e tregut primar. Kërkesa për fonde nga Ministria e Financave nga njëra anë dhe rritja e normës së interesit të repove nga ana tjetër, kanë çuar në rritjen e *yield*-it të bonove të thesarit. Rritjen më të ndjeshme, kjo diferencë e ka patur në afatet më të gjata të maturimit, ndërsa për afatin tremujor ajo paraqitet më e moderuar.

Si konkluzion, mund të themi që veprimet e Bankës së Shqipërisë në treg, të realizuara me anë të instrumenteve të politikës monetare, kanë arritur të transmetojnë politikën e saj. Veprimeve të Bankës së Shqipërisë i është përgjigjur dhe një angazhim më i lartë i bankave të nivelit të dytë. Ato kanë qenë aktive, veçanërisht në tregun ndërbankar, ku vëllimi i transaksioneve arriti nivelin më të lartë që nga tremujori i tretë i vitit të kaluar.

VIII.2. Normat e interesit të depozitave

Normat e interesit të depozitave kanë qenë relativisht të qëndrueshme gjatë tremujorit të tretë. Ecuria e normës së ponderuar të interesit të depozitave, si në total ashtu dhe për maturitetet e ndryshme, tregon një qëndrueshmëri relative të tyre.

Tabela 25: Interesi mesatar për pranimet e reja të depozitave në lekë (në përqindje)

Muajt	3 mujore	6 mujore	12 mujore	Sistemi
Korrik	6.87	7.24	7.69	7.06
Gusht	6.85	7.33	7.71	7.12
Shtator	6.88	7.26	7.71	7.10

Reagimi i bankave të nivelit të dytë pas ndryshimit të shpallur të normës së interesit për repot nga ana e Bankës së Shqipërisë, mund të konsiderohet normal. Nga analiza e vrojtimit për aktivitetin depozitues të tyre për periudhën maj – nëntor 2001, rezultoi se 26,3 për qind e bankierëve të intervistuar përgjigjen se janë rritur normat e interesit, 15.8 për qind se janë ulur dhe 57.9 për qind se nuk janë ndryshuar ato.

VIII.3. Normat e interesit të kredive

Interesi i ponderuar si sistem bankar për kreditë e akorduara në lekë gjatë tremujorit të tretë, krahasuar me një tremujor më parë u shoqërua me një tendencë të lehtë rritjeje prej 0.31 pikë përqindjeje. Megjithatë, kjo shifër është vështirë të interpretohet si një tendencë e konfirmuar apo përgjigje ndaj ngjarjeve të caktuara.

Kreditë e akorduara në lekë, edhe për këtë tremujor, përbëjnë një pjesë shumë të vogël në totalin e kredive të reja, rreth 17 për qind. Gjithashtu, normat e interesit të kredive në lekë variojnë sipas bankave, nga 13-22 për qind, dhe pak banka janë aktive në këtë treg. Duke qenë se kredi në lekë akordojnë një numër relativisht i vogël bankash ato bëhen dhe përcaktuese në interesin e ponderuar për kredinë e akorduar në lekë. Konkretisht, rritja e normës së interesit erdhi si pasojë e rritjes së lartë të interesit të ponderuar në muajin korrik, muaj në të cilin Banka Fead akordoi një numër të lartë kredish të reja me normë të lartë interesi. Nga ana tjetër, pas muajit korrik vërehet një ulje e interesit të ponderuar për kreditë e akorduara në lekë, nga 16.89 për qind në korrik, në 14.67 për qind në shtator.

Tabela 26: Normat e interesit të ponderuar për kreditë e akorduara në lekë

	Qer'01	Korr'01	Gush'01	Shtat'01
Kreditë deri 6 muaj	24.00	23.46	24.00	14.64
Kreditë 6m-1vit	13.98	15.70	13.93	13.87
Kreditë 1-3 vjet	14.58	17.91	18.90	18.17
Kreditë mbi 3 vjet	15.22	13.33	14.00	17.00
Kreditë gjithsej	14.36	16.89	14.72	14.67

Nga ana tjetër, normat e interesit të kredive në valutë kanë patur ulje gjatë tremujorit të tretë, si për kreditë në euro edhe për ato në usd. Në këtë ecuri ka ndikuar ulja e vazhdueshme e normave të interesit të valutës në tregjet ndërkombëtare, e cila ka sjellë uljen e normave të interesit në tregun e brendshëm si për depozitat edhe për kreditë në valutë.

Tabela 27: Normat e ponderuar e interesit për kreditë e akorduara në valutë për vitin 2001

Periudha	Në usd	Në euro
Janar	10.07	11.71
Mars	9.52	8.20
Qershor	10.28	7.55
Shtator	7.46	6.64

Ecuria në drejtime të kundërta e normave të interesit të kredive në lekë dhe në valutë, mungesa e konkurrencës, copëzimi dhe segmentimi i tregut si për monedhën e përdorur ashtu edhe për normën e interesit të zbatuar, tregon edhe një herë që në Shqipëri mungon një treg i mirëfilltë i kredive bankare, ku norma e interesit të përcaktohet në mënyrë të qëndrueshme nga ballafaqimi i kërkesës me ofertën në treg.

Për vitin 2002, në tërësi, programi ekonomik parashikohet të jetë në të njëjtin kuadër si edhe viti 2001. Në këtë mënyrë është programuar rritje ekonomike në masën 7 për qind në terma realë duke siguruar inflacion të ulët në nivelin 2-4 për qind. Deficiti buxhetor dhe financimi i brendshëm i tij në raport me PBB-në do të vijojnë tendencën e tyre drejt uljes. Investimet e huaja, sidomos të ardhurat nga privatizimi, dhe investimet publike pritet të kenë rritje të mëtejshme. Megjithatë, problemi i krizës energjitike për ekonominë e vendit mbetet ende i hapur, për sa kohë që projekteve dhe strategjive të hartuara për përmirësimin e situatës energjitike në vend nuk u njihet plotësisht efektiviteti i tyre. Po ashtu, përballë një përkeqësimi të mundshëm të ritmeve të rritjes së ekonomisë botërore për vitin që vjen, ekonomia shqiptare nuk mund të qëndrojë indiferente. Të dyja këto probleme madhore, tashmë ekzistuese, përbëjnë sfidat për arritjen e objektivave për rritjen ekonomike dhe inflacionin për vitin e ardhshëm.

* *
*